

Zyrës së doktoratave të Universitetit të Tetovës

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit filozofik i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 30.08.2023, solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull “**Ndërtimi i kohezionit shoqëror si faktor për integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian**” të kandidatit **Mr. Sc. Behar Mjekiqi**.

Në bazë të vendimit nr. **Nr. 16-419/2** të datës **30.08.2023**, Komisioni në përbërje: 1. Prof. dr. Ibish Kadriu, mentor, 2. Prof. dr. Abdylnaser Sinani, anëtar, 3. Prof. dr. Qani Nesimi, anëtar, 4. Prof. dr. Kushtrim Ahmeti, anëtar, 5. Prof. dr. Ardita Abdul-Reka, anëtar, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit filozofik i paraqet këtë:

R A P O R T

për vlerësimin e disertacionit të doktoratës

Të dhënat biografike të kandidatit:

Mr.sc. Behar Fadil Mjekiqi ka lindur më 23.03.1984, me vendbanim në Komunën e Obiliqit të Republikës së Kosovës, ku edhe jeton aktualisht.

Mr.sc. Behar Mjekiqi është doktorant i shkencave të Sociologjisë, në drejtimin socio-politik, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës. Në vitin 2020 Behar Mjekiqi mori titullin Magjistër i Shkencave të Sociologjisë, kur me sukses mbrojti tezën e magjistraturës me titull “Pluralizmi politik dhe roli i partive politike në ndërtimin dhe fuqizimin e sistemit demokratik në Republikën e Kosovës”.

Shkollimin fillor e kreu në vendin e tij të lindjes Shipitullë të Komunës së Obiliqit (1991-1998), shkollimin e mesëm e kreu në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë (1999-2003). Në vitin akademik 2010-2011 përfundon studimet e ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave Islame në Jemen.

Nga viti 2011 fillon punën si imam në Xhaminë e Vjetër në Obiliq, ndërsa nga viti 2012 e kryen funksionin, Kryetar i Bashkësisë Islame – Obiliq, funksion që e kryen edhe aktualisht.

Në vitin akademik 2023/2024 është i angazhuar si bashkëpunëtorë i jashtëm (part-time) në Fakultetin Filozofik, drejtimin e Sociologjisë në Universitetin e Tetovës ku ligjerëron lënden: Ndryshimet shoqërore dhe globalizimi.

Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoratës kandidati Mr. Sc. Behar Mjekiqi i ka kryer me sukses provimet përkatëse, konferencat doktorale, dhe obligimet tjera të parapara me Rregulloren për studimet e doktoratës të Universitetit të Tetovës.

Veprimtaria Shkencore

2023	Autor i librit “Pluralizmi Politik dhe shtetndërtimi i Republikës së Kosovës”	ISBN: 978-608-4971-25-2
ALBANOLOGJIA International Journal of Albanology, 10 (19-20). pp. 151-158.	Punim shkencorë me titull: “Politika dhe audiencia në mjedisin e ri të mediave, në Republikën e Maqedonisë së Veriut”	UDC: 316.774:654.1
International Journal of Albanology, 9 (17-18). pp. 109-115	Media hybriditi and albanian political parties i RNM, the relationship between them	UDC: 316.774:329 (=18)
International Journal of Social and Human Sciences, 8 (15-16). pp. 14-23	Ethics in political sociology	UDC: 32:17.02 17:316.334.3

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidatja gjatë studimeve të doktoratës:

Kandidati Mr. Sc. Behar Mjekiqi që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoratës e këndej, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoratës. Ai me sukses ka realizuar tre konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar disa punime, artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

Analizë e punimit të doktoratës me titull – “Ndërtimi i kohezionit shoqëror si faktor për integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian”

Ky disertacion i doktoraturës në tërësinë e tij ndahet në dy pjesë kryesore; në pjesën teorike dhe atë empirike.

Pjesa teorike e punimit ka trajtuar konceptin e Kohezionit shoqëror, duke përfshirë këtu definicionet dhe përkufizimet mbi të, elementët, dimensionet dhe faktorët e këtij koncepti, qasjen evropiane të konceptit të kohezionit etj. Gjithashtu, pjesa teorike ka përfshirë tematika të cilat në punimin e doktoraturës janë përdorur si varaibla kryesore dhe atë; Përfshirja dhe vendimarrja e qytetarëve në jetën shoqërore politike të Kosovës, ndërtimi dhe funksionimi i administratës publike në Kosovë, lufta kundër krimit dhe korrupsionit, bashkëpunimi rajonal, dialogu Kosovë-Serbi, të gjitha këto me qëllim të identifikimit të nivelit dhe gjendjes së Kohezionit shoqëror në Kosovë, dhe mundësisë për përmirësimin e politikave shtetërore në këtë drejtim.

Pjesa empirike e këtij disertacioni përfshin grumbullimin, analizën, dhe interpretimin e rezultave për të nxjerrë përfundimet, dhe sugjerimet nga hulumtimi, i cili jep një pasqyrë të qartë për zbardhjen e perceptimit të qytetarëve kosovar mbi konceptin e kohezionit shoqëror dhe varshmërinë me procesin e integritimit. Me një qasje të kombinuar metodologjike, grumbullimi i të dhënave, analiza dhe interpretimi tyre, ofron trajtim empirik të disertacionit të doktoraturës, sidomos në fazën e kërkimit të përgjigjeve të përfshira në pyetësorin anketues, si në vijim:

- Sa janë të përfshirë qytetarët e Kosovës në proceset shoqërore politike dhe vendimarrje?,
- Sipas cila parimeve është e ndërtuar administrata publike në Kosovë?
- Sa janë të përfshira pakicat etnike në institucionet dhe jetën politike të Kosovës?
- A ndikon dhe sa ndikon Kohezioni shoqëror në procesin integrues?
- Cilat janë pengesat kryesore të Kosovës gjatë rrugës së integritimit?
- A duhet Kosova të jetë pjesë e nismave rajonale jashtë Procesit të Berlinit, siç është rasti me “Open Ballkan”?
- A do të përkrahin qytetarët e Kosovës integrimin e Kosovës në BE, në rast të ndonjë referendumi?etj.

Argumenti kryesor që përshkon gjithë punimin është fakti se procesi i integritimit të Kosovës duket se është i lidhur ngushtë me krijimin dhe ndërtimin e një shoqërie me kohezion të lartë, që

nënkupton se duhet të respektohen parimet e këtij koncepti si dhe dhe vlerat themelore të demokracisë.

Disertacioni i doktoraturës i kandidatit Mr.sc. Behar Mjekiqi është zhvilluar në mënyrë të organizuar dhe sipas planit dhe rregullores për punë shkencore. Struktura e punimit përbëhet nga 7 (shtatë) kapituj, dhe nga pjesët përbërëse të tyre, që janë në funksion të sqarimit dhe plotësimit të kapitullit përkatës.

Kreu i parë:

Në kapitullin e parë bëhet fjalë për kohezionin shoqëror, zhvillimin e konceptit gjatë historisë, definimin dhe përkufizimin e kohezionit shoqëror, komponentët e kohezionit social faktorët kryesorë për ndërtimin e shoqërisë kohezive si dhe për qasjen evropiane ndaj kohezionit shoqëror.

Kreu i dytë:

Në kapitullin e dytë janë paraqitur disa të dhëna dhe tregues të gjendjes së Kohezionit shoqëror në Kosovë, të bazuara në disa hulumtime të organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Gjithashtu, janë analizuar dhe përshkruar gjetjet kryesore të këtyre hulumtimeve si dhe janë identifikuar faktorët kryesorë të cilat përcaktojnë gjendjen e nivelit të kohezionit në Kosovë. Në këtë kapitull janë trajtuar pritshmëritë e qytetarëve kosovarë në raport me zbatimin e parimeve dhe normave të modelit social evropian.

Kreu i tretë:

Në këtë kapitull trajtohen hollësisht disa procese shoqërore politike dhe dukuri shoqërore të cilat njëherësh janë marrë si variablat e këtij disertacioni doktore. Në këtë drejtim, është bërë një skanim i gjendjes në disa drejtime apo fusha socio politike dhe atë; analizë e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes së qytetarëve kosovarë në proceset shoqërore politike, përfshirja e pakicave etnike në proceset politike dhe në institucionet e Kosovës, ndërtimi dhe funksionimi i administratës publike si dhe lufta kundër korrupsionit në Kosovë.

Kreu i katërt:

Kapitulli i katërt gjerësisht dhe thellësisht trajton integrimin si proces strategjik nëpërgjithësi, si dhe integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian në veçanti.

Në fillim të kapitullit flitet për rëndësinë e integritit, parimet, vizionet dhe pritshmëritë nga ky proces, mandej trajtohet çështja e integritit të rajonit (Ballkanit Perëndimor) në BE, duke nxjerrë në pah rëndësinë e bashkëpunimit rajonal si një mundësi për përshpejtimin e këtij procesi.

Gjithashtu, në këtë kapitull flitet për rrugën të cilën duhet ta kalojë Kosova drej anëtarësimit në BE, për sfidat, kushtet, dhe kriteret që duhet të plotësojë, si dhe për mekanizmat mbështetës në këtë proces, siç janë Procesi i Sbilizim Asocimit (PSA), Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim (MSA) dhe instrumenta tjerë.

Në këtë kapitull analizohet rëndësia që ka ndërtimi i një shoqërie me kohezion të lartë në funksion të integritetit dhe anasjelltas, rëndësia e integritetit, si instrument ndihmës në ndërtimin e një shoqërie me kohezion më të lartë.

Kreu i pestë:

Në kapitullin e pestë në mënyrë më të detajuar është përshkruar aspirata e Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, me theks të veçantë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Poashtu janë trajtuar sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet Kosova gjatë këtij rrugëtimi.

Kreu i gjashtë:

Kapitulli i gjashtë në mënyrë të detajuar trajton dialogun Kosovë – Serbi, si një nga çështjet më delikate dhe më të komplikuar midis dy shteteve fqinje. Dialogu paraqet një nga kushtet më thelbësore për të dy shtetet në rrugën e anëtarësimit në strukturat euro-atlantike. Në këtë kapitull gjithashtu, analizohen rrjedhat e dialogut nëpër periudha të ndryshme, mandej shtjellohen dhe analizohen propozimet dhe marrëveshjet e arritura midis dy shteteve si dhe çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Një trajtim i veçantë i është kushtuar mangësive që i ka procesi i dialogut, problemet gjatë dialogut, botëkuptimet dhe qasjet e kundërta rreth zgjidhjes së problemit midis dy shteteve, kornizës dhe platformës për dialog, si dhe tiparet e konfliktit midis Kosovës e Serbisë.

Kreu i shtatë

Në kapitullin e shtatë është bërë analiza dhe interpretimi i rezultateve të fituara nga hulumtimi. Me qëllim të grumbullimit të të dhënave empirike në kuadër të punimit të disertacionit të doktoraturës me temë “Ndërtimi i Kohezionit shoqëror si faktor për integritetin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian”, është realizuar një hulumtim në terren me qytetarë të Kosovës, të zgjedhur rastësisht. Për realizimin e këtij hulumtimi (anketimi) është formuluar një pyetësor anketues (me 15 pyetje) i cili është realizuar në një kampion prej 100 qytetarëve nga i gjithë territori i Kosovës.

Kampioni i zgjedhur i ka këto karakteristika:

mosha	18 -25 vjeç	26- 50 vjeç	mbi 50 vjeç	gjithsej
Nr. i të anketuarve	34	40	26	100

Sipas gjinisë;

Gjinia	Femërore	mashkullore	gjithsej
Nr. i të anketuarve	48	52	100

Sipas përgatitjes shkollore;

Niveli arsimor	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë	gjithsej
Nr. i të anketuarve	40	60	100

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Korniza metodologjike

Tani më është bërë e ditur se koncepti i Kohezionit shoqëror si dhe integrimi, si procese janë dinamike dhe hulumtimi i tyre në drejtim të identifikimit të shkallës dhe nivelit të zhvillimit apo ekzistencës së saj në një shoqëri, është një punë komplekse dhe serioze. Kjo, së paku kërkon angazhim maksimal si dhe përvojë për të caktuar rrugët apo metodat e duhura hulumtuese me qëllim të arritjes së rezultateve të pritura.

Në këtë punim janë përdorur këto metoda kryesore shkencore:

- Metoda e analizës së përmbajtjes - Është përdorur literaturë teorike shkencore e huaj rreth konceptit të Kohezionit shoqëror, janë analizuar dhe studiuar përmbajtjet e raporteve të Komisionit Evropian për progresin e Kosovës në rrugën drejt integrimit, si dhe përmbajtja e qasjes evropiane për Kohezion shoqëror, vendimet e Qeverisë së R. së Kosovës, disa dispozita ligjore të

dala nga Kuvendi i R. së Kosovës, raporte nga puna e organizatave joqeveritare nga Kosova dhe ndërkombëtare si dhe literaturë themelore shkencore sociologjike dhe politike.

- Metoda statistikore - Me anë të kësaj metode është bërë grumbullimi dhe klasifikimi i të dhënave mbi ecurinë dhe gjendjen e kohezionit shoqëror ku si indikatorë janë marrë: zbatimi i parimeve demokratike, reformat e administratës, lufta kundër korrupsionit, punësimi, arsimi, krijimi i rrjeteve sociale dhe funksionimi i tyre në R. e Kosovës. Për kuptimin sa më të qartë të tyre, janë përdor tabela dhe grafikone.

- Metoda e anketimit- Për grumbullimin e të dhënave konkrete nga terreni (të gjitha rajonet e Kosovës) në lidhje me problemin hulumtues, dhe me qëllim të verifikimit të hipotezës kryesore dhe atyre të veçanta, është përdorur metoda e anketimit, ndërsa si instrument kryesor pyetësori. Pyetësori i përpiluar përmban pyetje të hapura rreth funksionimit të institucioneve shtetërore në zbatimin e politikave për arritjen e Kohezionit shoqëror si edhe pyetje nga fusha e integritit dhe dialogut Kosovë- Serbi.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Procesi i integritit dhe koncepti i kohezionit për nga natyra janë dinamike, prandaj identifikimi i mundësive për ndërlidhjen midis tyre do të paraqiste një sukses të jashtëzakonshëm për shoqëritë dhe shtetet në tranzicion.

Detyrat e hulumtimit:

- Sensibilizimin e opinionit të gjerë për rolin dhe rëndësinë e Kohezionit shoqëror dhe të integritit si dy procese të ndërvarura mes veti.
- Trajtim i këtyre dy proceseve nga këndvështrimi sociologjik
- Promovimi i R. së Kosovës si shtet demokratik i përkushtuar për integritet euroatlantike
- Sensibilizimi i organizatave të ndryshme për hapjen e debatit publik më të gjerë për nevojën e domosdoshmërisë së arritjes dhe përpilimin e strategjisë për ngritjen dhe fuqizimin Kohezionit shoqëror në R. e Kosovës.

Hipotezat:

Hipoteza e përgjithshme e hulumtimit është;

H1. “Në qoftë se R. e Kosovës arrin të krijojë shkallë të lartë të Kohezionit shoqëror, atëherë krijohet mundësi për përshpejtimin e procesit të integritimeve Euroatlantike”

Hipotezat e veçanta të hulumtimit janë;

Hv1 - “Kohezioni social në R. e Kosovës nuk është në nivelin e duhur”

Hv2- “Zbatimi i parimeve demokratike dhe i Kohezionit, forcon kapacitetin e institucioneve politike dhe shoqërore të Republikës së Kosovës” “

Variablat e hulumtimit janë:

- Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Shkalla e zhvillimit të Kohezionit shoqëror;
- Përfshirja e qytetarëve në proceset shoqërore politike;
- Lufta kundër korrupsionit;
- Ndërtimi dhe forcimi i administratës publike;
- Përfaqësimi i pakicave etnike në institucionet e Kosovës;
- Shkalla e organizimit institucional dhe funksionaliteti i tyre;
- Dialogu Kosovë – Serbi dhe
- Marrëveshjet me BE (PSA, MSA).

Ky punim doktrate, konsiston në identifikimin e shkallës së Kohezionit shoqëror dhe ndjekjen e ecurisë së tij nga koha e Pavarësisë (2008). Qëllimi teorik-shkencor konsiston në hulumtimin dhe afirmimin e mundësive për forcimin e Kohezionit shoqëror me qëllim të përshpejtimin të procesit integruar të R. së Kosovës, me vështirësi të veçantë në mundësitë e promovimit dhe forcimit të konceptit të Kohezionit shoqëror dhe procesit të integritimit. Rezultatet nga ky punim doktrate vërtetojnë hipotezën kryesore se; për shkak të nivelit jo të kënaqshëm të kohezionit shoqëror, integrimi i Republikës së Kosovës në BE zhvillohet në mënyrë të ngadaltë dhe jo të kënaqshëm. Sipas kësaj, rekomandohet që autoritetet përkatëse si dhe shoqëria kosovare duhet të zbatojë parimet kryesore të konceptit të kohezionit shoqëror me qëllim përshpejtimin të procesit integruar.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:

Disertacioni i doktoraturës i kandidatit Mr. Behar Mjekiqi, është i realizuar në fushën e sociologjisë, saktësisht në sferën e sociologjisë politike, më specifikisht në ndikimin e kohezionit shoqëror në procesin e integrimit.

Qëllimim teorik-shkencor konsiston në identifikimin, hulumtimin dhe afirmimin e mundësive për forcimin e konceptit të kohezionit shoqëror me qëllim të ndikimit në përshpejtimin të procesit integrues të R. së Kosovës, me vështrim të veçantë në mundësitë e promovimit dhe forcimit të konceptit të kohezionit shoqëror. Procesi i integrimit dhe koncepti i kohezionit për nga natyra janë dinamike, prandaj identifikimi i mundësive për ndërlidhjen midis tyre do të paraqiste një sukses të jashtëzakonshëm për shoqëritë dhe shtetet në tranzicion.

Ky punim doktore, duke qenë se përbën një hulumtim inovativ, që nënkupton se deri sot nuk janë bërë studime dhe hulumtime të hollësishme sa i përket konceptit të Kohezionit shoqëror dhe ndikimit të tij në procesin e integrimit, pritet të japë një kontribut cilësor në kuptimin e koncepteve por edhe në kuptimin mbi varshmërinë midis këtyre koncepteve me aspiratën qytetare për ndërtimin e shtetit demokratik të integruar dhe anëtarësuar në organizatat ndërkombëtare, përfshirë edhe Bashkimin Evropian.

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se studimi i lidhshmërisë midis forcimit të kapaciteteve institucionale përmes zbatimit të parimeve të konceptit të kohezionit shoqëror, me procesin e integrimit, sjell në pah vlerat e shteteve demokratike të mirëfillta dhe dobinë për të gjithë qytetarët. Transformimet shoqërore të nevojshme të cilat duhet ti ndërmarrë shteti i Kosovës si detyrim për përmbushjen e kriterëve nga procesi i integrimit, sjellin të mira të shumta për të gjithë qytetarët në të gjitha fushat e jetës.

Me qëllim të realizimit të këtij synimi, kandidati Mr. Sc. Behar Mjekiqi, ka shfrytëzuar literaturë të bollshme shkencore nga fusha e sociologjisë politike, dhe punimi i doktoratës është realizuar sipas kriterëve dhe standardeve që kërkon një punim shkencor.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:

Disertacioni i doktoratës me temë “Ndërtimi i kohezionit shoqëror si faktor për integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian”, përfshin një studim shumë të gjerë, por në të njëjtën kohë arrin specifikat e shumta të aplikuar por pak të njohura shkencërisht

në Republikën e Kosovës për rolin i Kohezionit shoqëror që ka për ndërtimin e një shoqërie dhe institucioneve funksionale dhe në përshpejtimin e procesit integrues të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Duke u nisur nga kjo, është për tu vlerësuar përpjekja dhe angazhimi i kandidatit me qëllim të rritjes dhe zgjerimit të njohurive shkencore mbi kohezionin shoqëror por edhe varshmërinë që ka ky koncept me procesin e integritimit.






Prandaj, çështjet e ngritura në këtë disertacion janë një kontribut jo vetëm për sferën e sociologjisë apo të politikës, por në të njëjtën kohë ndërlidhen edhe me implementimin e parimeve themelore të demokracisë në funksion të përmirësimit të jetës së përditshme dhe mirëqenien sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ky disertacion i doktoratës mund të shërbejë për hulumtime shkencore të mëtejshme në sferën e rëndësisë që ka koncepti i kohezionit shoqëror, me qëllim të forcimit të kapaciteteve institucionale, por edhe në drejtim të rëndësisë që ka përfshirja e qytetarëve në proceset shoqërore politike dhe vendimarrje, gjithashtu, përfshirja e pakicave etnike në jetën politike brenda institucioneve, me qëllim të ruajtjes së karakterit unitar të shtetit, ndërtimi i një administrate publike në shërbim të qytetarëve dhe mbi parimet e meritokracisë, luftën kundër krimit dhe korrupsionit etj., si dhe në senzibilizimin e të gjithë përbërësve shoqëror që nga politika e deri te qytetari më i zakonshëm për rëndësinë e procesit integrues.

Vlerësim dhe rekomandim:

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës me titull “Ndërtimi i kohezionit shoqëror si faktor për integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian”, të kandidatit Mr. Sc. Behar Mjekiqi, ka nderin që t’i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Ibish Kadriu, mentor  ;
2. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani, anëtar  ;
3. Prof. Dr. Qani Nesimi, anëtar  ;
4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, anëtar  ;
5. Prof. Dr. Ardita Abduli-Reka, anëtar  ;

Tetovë, 2024